



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Vlorë më, 11. 07. 2019

**VENDIM**

**Nr. 34, datë 11. 07. 2019**

**PËR**

**RIORGANIZIMIN E GRUPEVE MËSIMORE, KËRKIMORE SHKENCORE TË  
DEPARTAMENTIT TË GJUHËVE TË HUAJA**

Mbështetur në neni 49, pika 1, shkronja dh, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin Nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në IAL" Vendimin Nr. 23, datë 19. 06. 2019 të Senatit Akademik si dhe relacionin shoqëruar të Administratorit të U.V-së Nr. 879/1 prot, datë 03.07.2019, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 11. 07. 2019,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë krijimin e grupit mësimor me karakter kërkimor- shkencor të studimeve përkthimore dhe gjuhës për qëllime të posaçme pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja.
2. Grupet mësimore me karakter kërkimor- shkencor pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja do të jenë të organizuara si më poshtë:
  - a. Grupi mësimor- kërkimor i Gjuhësisë ( gjashtë anëtarë me kohë të plotë)
  - b. Grupi mësimor- kërkimor i Mësimdhënies në Gjuhë të Huaja (gjashtë anëtarë me kohë të plotë)
  - c. Grupi mësimor- kërkimor i Letërsisë dhe Studimeve Kulturore (shtatë anëtarë me kohë të plotë).
  - d. Grupi mësimor- kërkimor i Studimeve Përkthimore dhe Gjuhës për Qëllime të Posaçme (5 anëtarë me kohë të plotë).
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi stukturat përgjegjëse pranë Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

5. Bashkangjitur këtij vendimi, vendoset një kopje e shkresës Nr. 879/1 Prot., datë 03.07.2019 e Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, së bashku me dokumentacionin shoqërues.

Anjeza Shiko – Anëtar

Rajmonda Simoimeri – Anëtar

Enrik Mehmeti – Anëtar

Dr. Elsajed Rexhaj – Anëtar

Dr. Enida Pulaj – Anëtar

Dr. Marinela Muço – Anëtar

Dr. Ervis Moçka – Kryetar

